

VENDIM
Nr. 469, datë 9.7.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1252, DATË 10.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ZHVILLIMIT TË TENDERIT PUBLIK PËR DHËNIEN E SË
DREJTËS SË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pikat 1 e 3, dhe 69, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në dokumentin “Rregullat e zhvillimit të tenderit publik për dhënie të së drejtës së përdorimit të frekuencave”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pika 4.4, e kreut III, “Zhvillimi i procedurave”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama